

U zhvillua një takim me studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës

Më datën 8 Prill 2015, në kuadrin e përfshirjes së edukimit në fushën e standardizimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit me Universitetet, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësuese, duke realizuar takimin e radhës me studentë nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës, Fakulteti Ekonomik - Dega Administrim-Biznesi.



Zoti Riza Hasanaj, Drejtori i Përgjithshëm i DPS-së pati një takim të shkurtër me studentët, ku ndër të tjera siguroi se ndërgjegjësimi i studentëve, si gjenerata më e afërt e ardhshme që do të përdori standardet, është një nga përparësitë e punës së DPS-së në këtë drejtim. Më pas Znj. Kostanca Dedja – Drejtore, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Palët dhe Znj. Anita Reçi dhe Znj. Olta Bane – Specialiste në Sektorin e Promovimit dhe Marketingut prezantuan kuadrin ligjor dhe

funksionimin e sistemit të standardizimit në Shqipëri si dhe mjetet e komunikimit dhe burimet e informacionit mbi standardet.

Nga Universiteti i Shkodrës ishin të pranishëm PhD. Brikene Dionizi - Pedagogia e lëndës “Menaxhimi i Cilësisë” dhe rreth 30 studentë të vitit të tretë, Administrim-Biznesi.

Takimi u zhvillua në formë bashkëbisedimi me studentët të cilët ishin të interesuar si për të patur një informacion të përgjithshëm mbi sistemin e standardizimit dhe mënyrën e funksionimit të tij, ashtu edhe për pyetje e aspekte konkrete se: Çfarë është një standard? Çfarë bëjnë standardet për Ju? Si mund të blijnë një standard? A aplikon DPS ulje në çmimin e standardeve? dhe veçanërisht Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë duke marrë si shembull implementimin e standardit SSH EN ISO 9001:2008 nga DPS.



Standardi SSH EN ISO 9001:2008 u mor si shembull konkret për të kuptuar çfarë është një standard, përfitimet dhe rëndësia në përdorimin e standardeve. Gjithashtu, u përdorën dy artikuj ndihmës mbi Serinë 9000 – “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” dhe përfitimet e drejtëpërdrejta nga përdorimi i tyre.

Në fund të prezantimit studentët u njohën me publikimet e DPS, vendosur në dispozicion në stendat dhe tavolinat e promovimit; materiale këto që mund t'i ndihmojnë gjatë procesit të studimit apo edhe në zhvillimin e temave të diplomës në këtë fushë.

Broshurat rreth DPS (misioni, organizimi, publikime e rëndësishme, kontakte etj); Krijimin e përfitimeve nga standardet për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME-të); Udhëzuesi i Menaxhimit të Shërbimeve; Ju jetoni 24 orë me standarde; Si të marrim pjesë në procesin e standardizimit, etj. ishin disa nga materialet ndaj të cilave studentët treguan vëmendje më të madhe.

Gjithashtu, DPS prezantoi të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion (tel, fax, faqjen zyrtare e internetit, profilet e DPS-së në mediat sociale) duke krijuar mundësinë për komunikim dhe informim të vazhdueshëm në të ardhmen.

Studentët e vitit të tretë Administrim Biznesi, potencialisht të gatshëm për tregun e punës, zhvilluan vizita të shkurtra në vendet e punës, në sektorin e Promovimit dhe Marketingut dhe Sektorin e Shitjes së standardeve, duke parë në praktikë proceset e punës në DPS.